



Protokoli i shkurtë i mbledhjes së Kuvendit të nëntë të rregullt të BISHZ-së më 18.11.2006

Vendi: Adresa: Hotel Novotel Bern Expo, Am Guisanplatz 2, 3014 Bern.
Data: E shtunë, 18 nëntor 2006 / 15.00-18.00
Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar)
Pjesëmarrës: Rreth 40

Pikat e rendit të ditës

Programi

Pjesa e parë: Kuvendi i nëntë i rregullt

1. 15:00 Hapja e Kuvendit (Inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar)
2. 15:05 Fjala hyrëse dhe vështrim i shkurtë i punës nëntëvjeçare të BISHZ-së (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)
3. 15:10 Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 19.11.2005 - 18.11.2006 (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)
4. 15:15 Ndarja e mirënjohjeve (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)
5. 15:20 Si më tutje? => E mirëpresim fjalën e të ftuarëve për Shoqatën BISHZ-së; këshilla, mendime, vërejtje, ide, ...?! (Abas Fejzullahi, sekretar)
- 15:55 Mbyllja e Kuvendit (Inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar)

Pjesa e dytë: Promovim/Paraqitje të librave

6. Promovimi i librave "Fisnikëria Helveto-Ilire" dhe "Amerika në sytë e mi" të autorit Agim Shehu
16:00 Fjala hyrëse dhe paraqitje e shkurtër e jetëshkrimit të Agim Shehu (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)
16:10 Leximi i disa pjesëve të librave (Agim Shehu)
16:30 Pushim
17:00 Diskutime
7. Paraqitja e dy librave poetike "Pesha e gurit" dhe "Fillo me të mbarë" të autorit Mehmet Haxhosaj
17:20 Fjala Hyrëse dhe paraqitje e shkurtër e jetëshkrimit të Mehmet Haxhosaj (Abas Fejzullahi, sekretar)
17:30 Leximi i disa pjesëve të librave (Mehmet Haxhosaj)
17:45 Diskutime
18:00 Mbyllja e promovimit/paraqitjes (Abas Fejzullahi, sekretar)



Pjesa e parë: Kuvendi i nëntë i rregullt

1. 15:00 Hapja e Kuvendit (Inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar)

Sipas programit të paraparë z.Sinollah Shehu, nënkryetar, bëri hapjen e Kuvendit të nëntë të rregullt dhe i përshëndeti të pranishmit në përgjithësi dhe pjesëmarrjen e Ambasadorit të Shqipërisë në Zvicër në Bernë, z. Mehmet Elezin me bashkëshortën e tij dhe të shkrimtarit të mirënjohur z. Agim Shehun në veçanti në këtë Kuvend. Në vazhdim i'a dha fjalën kryetarit të shoqatës BISHZ z. Ahmet Xhigolit për të vazhduar rrjedhën e Kuvendit sipas programit të punës.

2. Fjala hyrëse dhe vështrim i shkurtë i punës nëntëvjeçare të BISHZ-së (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)

Kryetari i Shoqatës z. Ahmet Xhigoli përshëndeti po ashtu të pranishmit dhe pastaj bëri një vështrim të shkurtër të punës nëntëvjeçare të BISHZ-së në përgjithësi dhe përbaljen me mungesën e mjeteve financiare, për të realizuar veprimtaritë e saja në ato drejtime ku pa mjete s'ka mundësi të realizohen. Si p.sh. drejtimi i botimeve dhe publikimeve të jashtme, ku përmendi Revisten shkencore, kulturore, artistike dhe sportive "Bashkimi" që është botuar vetëm një numër, ndërsa numërat tjerë presin dhe s'ka mundësi të botohen për shkak të mungesës të mjeteve financiare.

3. Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 19.11.2005 - 18.11.2006 (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)

Në vazhdim dha disa shpjegime rreth punës njëvjeçare të paraqitur në Raportin vjetor sipas kapitujve lidhur me aktivitetet e zhvilluar në ato drejtime ku ka pasur mundësi të investohet nga ana e anëtarësisë dhe kryesisë dhe falënderoi për mbështetjen e tyre vullnetare në realizimin e programit të paraparë njëvjeçar duke i realizuar me sukses këto veprimtari: Në drejtimin e arsimit dhe kulturës në bashkëpunim me Këshillin e Lidhjes së Arsimtarëve dhe Prindërve Shqiptarë të Kantonit të Solothurnit dhe kantoneve tjera të Zvicrës ku zhvillohet mësimi plotësues nga gjuha dhe kultura shqiptare është organizuar ora letrare për nder të ditës së Flamurit tonë kombëtar me temën: "Ta zgjedhim recituesin më të mirë" ku pas takimit që ka pas karakter garues dhe manifestues janë ndarë nga shoqata për të gjithë nxënësit pjesëmarrës dhurata modeste, ndërsa dhurata të veçanta u janë dhënë fituesve sipas vlerësimit të jurisë nga ana e shoqatës dhe LAPSH-rë. Po ashtu me sukses janë realizuar edhe takimet në Sport udhëhequr nga zot. Agim Gerbavci për fëmijët e moshës 10-14 vjeç në nivel të Zvicrës si dhe Takimi Familjar i cili më tani është bërë tradicional me anëtarët dhe familjarët e Shoqatës dhe miqët e dashmirët e tyre. Po ashtu aktiviteti tjetër i realizuar me sukses është bërë pothuajse i rregullt për çdo vitë më 10 qershor organizohet: Tryeza e Rumullakët, me tema të ndryshme lidhur me Kosovën dhe situatën e saj, ku kanë marrur pjesë me punimet e tyre-referate nga shoqata e jonë dhe nga bashkëpunëtorët tanë të paraqitur sipas temave të përcaktuara nga të gjitha trojet e Shqipërisë Etnike dhe nga mërgata këtu në Zvicër.

Punimet e lexuara janë publikuar edhe në shtypin e përditshëm si Zëri i Ditës, Bota Sot dhe së shpejt do të mund lexohen edhe në faqen e Shoqatës www.bishz.ch në Internet.

Raportin e punës njëvjeçare, tani e keni secili dhe pasi ta lexoni ne do t'i mirëpresim vërejtjet dhe mendimet e juaja në afatin prej 15 ditësh, dhe pastaj do të publikohet edhe në web-faqen tonë me plotësimet e arsyeshme të arritura.



4. Ndarja e mirënjohjeve (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)

Në këtë pikë të rendit të ditës Kuvendi shpalli Anëtar Nderi Z. Agim Shehun si dhe u ndanë pesë mirënjohje dhe një falenderim. Z. Ahmet Xhigoli, kryetar i dha disa shpjegime të shkurtëra duke theksuar se Shoqata BISHZ për anëtarët e saj dhe për veprimtarët tjerë të jashtëm që kanë kontribuar në drejtime të caktuara si në mbështetjen dhe mirëvajtjen e punës së Shoqatës apo edhe në veprimtari të tjera, si në artë, kulturë, shkencë dhe për çështje kombëtare brenda dhe jashtë shoqatës ndanë mirënjohje dhe falënderime. Ai, shtoi mëtejse që për veprimtar të dalluar në drejtimet e theksuara sipër, sipas Rregullores dhe Statutit në vlerësimet e bëra nga Kryesia shpall edhe anëtarët e nderit. Ne sot kemi nderin ta ftojme shkrimtarin dhe poetin e mirënjohur z. Agim Shehun i cili për herë të dytë bën promovimin e krijimtarisë së tij letrare në Shoqatën tonë të pranon vendimin e Kryesisë që e kemi shpall anëtarë nderi të Shoqatës tonë dhe njëherit Mirënjohjen për veprimtarin e tij letrare tani më të mirënjohur. Pra, në këtë kuvend, z. Xhigoli i ndau mirënjohje për Zotëri Jetish Bajrami, Zonjën Florije Rexhaj, Zotëri Besim Gërxhaliun dhe Falenderimin për Zotëri Adem Osmani.

5. Si më tutje? =>E mirëpresim fjalën e të ftuarëve për Shoqatën BISHZ-së;këshilla,mendime,vërejtje, ide,...?!

(Abas Fejzullahi, sekretar)

Në këtë pikë të rendit të ditës, sekretari i BISHZ-së, në mes tjerash tha: Ne në kryesin e shoqatës i diskutojmë çështjet me rëndësi për mirëvajtjen e punës në shoqatë dhe shprehim mendimet tona dhe kërkojmë mënyra dhe metoda më të përshtatshme e të mundshme për realizimin e qëllimeve të shoqatës. Mirpo mendoj se është me rëndësi edhe mendimi i të tjerëve jashtë shoqatës të cilët kanë pasur raste të marrin pjesë në Kuvendet e mëparshme apo edhe të njihfen përmes aktiviteteve dhe takimeve tjera si Tryeza të Rrumullakëta, takimeve familiare, takimeve letrare, takimeve sportive etj., që të dhënë mendimet e tyre, vërejtjet, këshillat apo edhe ide të cilat i mirëpresim dhe ju jemi mirënjohës për kontributin tuaj në këtë drejtim. Urdhëroni dhe tani Ju e kenë fjalën, të nderuar pjesëmarrës.

Nënkryetari z. Sinollah Shehu mori fjalën dhe tha: Ja japim fjalën Ambasadorit të Shqipërisë z. Mehmet Elezi.

Ambasadori z. Mehmet Elezi edhe pse siç tha ishte me një flamë, kur mësova se këtu në Bernë të Zvicrës ekziston dhe vepron një Shoqatë me emrin BISHZ, më ka ardhur shumë mirë dhe jam i këndur që gjindem në mesin tuaj. Në vazhdim, ai mes tjerash tha: Vlera e një kombi nuk varet e as matet nga numri, vëllimi, por matet me elitën e intelektualëve dhe veprimtarin e tyre për çështjen kombëtare. Dëshiroj të gjitha drejtimet e Shoqatës të zhvillojnë veprimtarin e tyre, por dua të theksoi një çështje sa i përket dallimit të intelektualëve dhe ekspertëve. Fatkeqësisht si në Shqipëri dhe në Kosovë këtë dallim se bëjnë si duhet! Sepse eksperti është diçka tjetër i specializuar në një drejtim të veçantë, ndërsa vlera e një intelektualit varet nga krijimtaria e tij në publicistikë dhe lëmi të tjera. Në fund shprehu fjalë të mira për shoqatën dhe i dëshiroj asaj mirëvajtje të suksesshme.

Fjalën e mori kryetari z. Ahmet Xhigoli dhe i njoftoi të pranishmit se nga anëtarët i nderit z. Astrit Leka kemi një letër pëshëndetse dhe lexoi disa pjesë dhe dha shpjegimin për arsyet e mungesës së tij në këtë Kuvend.

Për të folur u lajmërua shkrimtari i mirënjohur z. Agim Shehu, i cili tha: Është gjë e gëzueshme që marr pjesë në elitën e intelektualëve të cilët veprojnë për çështjen e atdheut. Lartësia e një populli matet nga intelektualët dhe veprimtaria e tyre, që shpeshherë përballen me vështësi edhe ato financiare e që edhe në të kaluarën rilindasit tanë si në vend dhe mërgatë janë përballur me vështësi të mungesës së mjeteve financiare dhe përmendi disa emra konkret. Shpesh herë ndodhë në praktikë e sidomos pas përfundimit të luftrave që krijohet një bindje se mjaft kemi dhënë dhe tani duhet të korren ato fitore, por harrojnë se për të korrur vazhdimisht duhet mbjellur përsëri, se po s' mbjelle s'ke çfarë të korrësh mëtejse. Vuri në pah mes tjerash se në një Shoqatë me rëndësi është që afirmimi i intelektualëve të jet në bazë të aftësive dhe veprimeve intelektuale në mënyrë të gjithanshme. Po ashtu e mori një shembull se për ta qar përpara çështjen kombëtare duhet plotësuar tri kushte:

- *Sigurimi i kokës me tru,*
- *Gjokës me lesh-trimëria,*
- *Xhepatë plotë- baza financiare.*



Kështu duke përfunduar fjalimin e tij ai tha se duhet hulumtuar mënyra dhe forma për një rregullator që do të gjinden mjetet financiare dhe i dëshiroj shoqatës punë të mbarë.

Në vazhdim sekretari i BISHZ-së Abas Fejzullahi ju drejtua pjesëmarrësve të marrin fjalën dhe të shprehin mendimet dhe shqetsimet e tyre edhe në drejtime tjera, siç është p.sh., rasti i Kosovës, gjendja atje, etj. Në vazhdim u ndërlihd në fajllimet paraprake dhe lidhur me çështjen financiare, duke përmendur se p.sh. Serbia vetem brenda një viti s'paku bën mbi 930 publikime kryesisht për dhe kundër Kosovës dhe Shqiptarëve në përgjithësi, përmes postës elektronike, botimeve dhe publikimeve të ndryshme, ku u shperndahen të gjitha përfaqësive diplomatike nëpër botë dhe zhvillon një propogandë në vazhdimësi me gënjeshttra e të pa vërteta, pra për Kosovën dhe Shqiptarët në përgjithësi. Ndërsa ne, lidhur me këtë çështje, me të vërtetat s' kemi një veprim të tillë fatkeqsisht as në Kosovë e as në Shqipëri. Vetem për ngjarjet e marsit 2004 në Kosovë, popi Artemija si përfaqësues i kishës ortodokse serbe në bashkëpunim me ASHAS, etj. në OKB dhe tërë botën shpërndan libra të përgatitura lidhur me djegjet dhe ngjarjet e përmendura si p.sh., është një libër prej 90 faqesh e autores Luljeta Selimi, në të cilën bëhet fjalë për dhunimet në Kosovë, tmerr, dhe s'kemi mundësi që ky libër të përkthehet në disa gjuhë të huaja dhe të shpërnadet për të njohur opinionin e jashtëm me të vërteten! Kjo është e dhimbshme dhe tragjike por kështu është!

Në vazhdim mori fjalën z. Imer Cacaj, i cili në fjalimin e tij ku mes tjerash tha: Është e vërtetë ajo se çfarë foli Abasi nga se disa herë i kemi diskutuar këto tema. Dhe tha se vetëm për të justifikuar po përmendi thënijen e akademikut serb Dobrica Qosiqit i cili thot: "...është nder i madh të gënjejsh për kombin..." ndërsa ne e kemi të drejten dhe argumentet dhe s'kemi mundësi me i plasuar sikurse që ata e plasojnë gënjeshtren, këte se bëjnë as qeveria e Shqipërisë as e Kosovës dhe as Akademitë tona, kjo është e tmerrshme. Lobi serb tha mu këtu në Zvicër ka qenë dhe është shumë i fuqishëm dhe vepron në mënyrë shumë të kordinuar kundër neve, përmendi grupin negociator dhe papëragtjtjet e tyre profesionale, propaganda e shtypit këtu në Zvicër për incidentet që bëhen nga ana e ndonjë shqiptari janë menjëhrë aty dhe e alarmojnë për të keq por jo rastet për të mirë. Theksoj se para disa kohësh s'ka pasur mundësi përgatitjen e një filmi dokumentar prej 58 minutash për Kosovën për opinionin e jashtëm ndërkombëtar për të treguar veprimet e Serbisë ndaj shqiptarëve vetëm se mungonte shuma prej 30 mijë frangash aso kohe, ndërsa për ahengje tjera e lëvizje njerëzish jashtë pa ndonjë kontribut konkret aso kohe hargjoheshin ndoshta 2-3 milionë!

Në ora 16:05 nënkryetari z. Sinollah Shehu shpalli të mbyllur punimet e Kuvendit.



Pjesa e dytë: Promovim/Paraqitje të librave

6. Promovimi i librave “Fisnikëria Helveto-Ilire” dhe “Amerika në sytë e mi” të autorit Agim Shehu

Z. Ahmet Xhigoli, kryetar i Shoqatës, lexoi jetëshkrimin e autorit z. Agim Sheut dhe pastaj ftoi autorin të flet lidhur me përmbajtjen e librave të tij.

Në kohën prej 25 minutash, autori foli për përmbajtjen e dy librave promovimi i të cilave bëhet sot në këtë Kuvend. Në vazhdim tha: “... Unë për ti shkruar këto dy libra që sot po bëjmë promovimin e tyre, bëra aq sa munda, por nuk e di se a kam bërë aq sa kërkon lexuesi...” Në të vërtetë fjalën për përmbajtjen e librave dhe vlersimin s’më takon ta jap unë, por këtë e jep lexuesi, ndërsa unë shkurtimisht pa ju marrur pak kohë po ju tregoi përmbajtjen dhe hulumtimin në dokumentacionin dhe literaturën e përdorur ndërsa mbarshtrimin artistik është çështje tjetër. Foli idhur me marrëdhëniet liro Zviceriane deri në ditët e sotme duke përmendur rolin e Mretit Dardan, Konstandin, rrënjet Ilire dhe toponimia e disa emërtimeve në Zvicër me prejardhje të fjaëve Ilire-shqipe si p.sh., Gjenevë—Gjuni etj. Në vazhdim tha se: Shqipëria është një Zvicër pa fat e me histori, dhe Zvicëra është një Zvicër me fat.

Ndërsa lidhur me përmbajtjen e librit: “Amerika në sytë e mi” foli për përshtypjet e tija për Amerikën që nga vegjëlja ku tregoi se në Shqipëri dhe Kosovë këndohej kënga “... Fustani me pika rroftë Amerika...” dhe përshtypjet e tija tani nga vizita e tij në SHBA. Në një kapitull flet për Universin e Presidentëve Amerikan, virtytet dhe humori i tyre, pastaj në veçanti përmendi Presidentin Vislon që shpëtoi Shqipërin dhe deri te Presidenti Klinton si shpëtimtar i Kosovës. Pastaj Holivudi dhe endrrat e aktorve për fam dhe aktor të njohur... etj.

Duke përfunduar z. Agim Shehu mes tjerash tha: Për atë se çfarë ndihme i ka dhënë Amerika dhe Presidentët e saj popullit Shqiptar dhe Humanizmi Zvicerian dhe ndima e Zvicrës në s’kemi se si t’ua kthejmë, por me këto libra unë si shkrimtar kam bërë përpjekjet e mia ti falenderoi për ndihmën e dhënë, në atë mënyrën që unë e kam mbarshtruar materialin, apo brumin e grumbulluar nëpër arkivat e enciklopedive të dokumentacioneve sikur bukëpjeksi që e përgatit brumin e gatuan bukën dhe e qet në treg me e shit, e konsumatorët e blejnë dhe e shijonë!

Pushimi

Gjatë pushimit prej 30 minutash jashtë sallës së hotelit në hapsirën e veçantë pjesëmarrësit u shërbyen me kafe, lëngje dhe ëmbëlsira, ku dhe paten rastin të njoftohen dhe bisedojnë mes veti.

7. Paraqitja e dy librave poetike “Pesha e gurit” dhe “Fillo me të mbarë” të autorit Mehmet Haxhosaj

Sekretari i BISHZ-së, Abas Fejzullahi, lidhur me rëndësinë e promovimit të librave siç është rasti me librat e shkrimtarit të mirënjohur Agim Shehut i cili tani më është edhe anëtar nderi i shoqatës mes tjerash tha:

“Në jetën e përditëshme ndodhin fenomene natyrore shkatruese si Tsunami, Uragana termete që rrënojnë hotele, ura pallate e vepra nga më të ndryshmet e luksoze dhe zhduken nga faja e dheut, por veprat e ndryshme letrare-artistike s’mund të shkatrohen sepse ato janë të shpërndara në tërë botën përmes bibliotekave, shkollave e universiteteve si dhe tek lexuesit dhe bibletekat e tyre individuale etj.

Andaj është nderë dhe kënaqësi për Shoqatën tonë kur bëjmë promovimin e librave siç është rasti edhe me librat e z. Agim Shehut etj. Në vazhdim bëri leximin e jetëshkrimit të shkurtër të poetit të ri z. Mehmet Haxhosaj dhe vazhdoi duke theksuar se unë s’jam kritik letrar dhe s’kam bërë ndonjë analizë në këtë drejtim, por librat i kam lexuar dhe më kanë pëlqyer si ajo me poezi për të rritur e në veçanti për fëmijë. Bëri një krhasim: Në ndërtimtari muratori ndërton murin e ndërtesën një dy apo shumë katshe, dhe nëse muratorit i bie një bllok apo tullë e thehet, s’bëhet dëm, e merr tjetrin, por në shkollë nëse thehet personaliteti i një fëmiju është tragjike, por edhe krijimi i personalitetit të fëmijës përmes veprave latrare artistike është me rëndësi të veçantë.

Në vazhdim, autori z. Mehmet Haxhosaj lexoi vet disa poezi nga libri për të rritur: “Pesha e Gurit” dhe libri për fëmijë: “Fillo me të mbarë” që u mirëpritën shumë mirë nga të pranishmit.



Diskutime

Sekretari i BISHZ-së hapi diskutimet lidhur me promovimin e librave.

Zonja Valbona Krasniqi mes tjerash tha: Unë kam pasur rast ta lexoi librin “Fisnikëria Helveto-Ilire” dhe kam përshtypjet e mia sa që shpesh herë mendoja sa gjëra si paskam ditur, duke menduar nga ato dokumente hulumtime që autori i mbarshtron në librin e tij, jam shumë, shumë e lumtur dhe e fascionuar nga se pata rastin të lexoj këtë libër dhe përgëzoi autorin për punën e bërë në mënyrë të mrekllueshme.

Dhe pyetja ishte konkrete ku dhe nga i gjetet gjitha ato të dhëna-dokumente e thënie...?

Autori z Agim Shehu, tregoi punën e tij hulumtuese në biblioteke, enciklopedi dhe dokumente të vjetra e literaturë arkivore, në Gjenevë etj. Pastaj autori foli për udhëheqësit Ilirë dhe Ilirinë dhe marrëdhëniet Iliro-Helvetike siç përmban edhe titulli i librit, duke përmendur disa emra nga toponastike në Zvicër dhe duke shpjeguar se kanë lidhshmëri dhe prejardhje Ilire.

Z. Ahmet Xhigoli e pyeti: Para se me udhëtua ju, për Amerikë kemi pas biseduar se do të udhëtoni dhe si kaq shpejt ju u frymzuat dhe shkruat librin “Amerika në sytë e mi” ?

Autori dha këtë përgjegje: Përshtypjet e mia për Amerikën kanë qenë që në vegjli, por me vizitën time dhe kontaktet atje që kam pasur, kamë përgatitur librin me përshtypjet e mia siç fola më parë dhe pas pak kohësh do të botoj pjesën e dytë-nga se kjo është pjesa e parë.

Abas Fejzullahi e pyeti: A mund të na thoni diçka lidhur me librin e Gjyzepe Katapanos “Thoti Fliste Shqip” Thot Tate parlare Albanese” ? Dhe si u bë që Iliria nga gjithë ai teritor të rrudhet ku sot jemi ?

Lidhur me pyetjen e parë zot. Agim Sheu dha këtë përgjegjeje: Iliret Pellazgët në Atlantidën e vjetër kanë pas shtrirje të gjërë gjeografike por edhe shpjegoj fjalet p.sh.: Deti Jon, Faraon.-Fara jonë, etj. që i shpjegon Gjyzepe Katapano dhe fjalë të tjera ku e permendi edhe Homerin etj.

Pas një diskutimi në këtë drejtim në ora 18:00, sipas programit të paraparë, përfundoi punën pjesa e dytë e programit të punës së Kuvendit të nëntë të rregulltë. Me përshtypjen se pjesëmarrësit ishin të kënaqur me atë që u fol dhe u dëgjua në këtë Kuvend, si gjatë diskutimeve, pushimit dhe perfundimit të tij.

*Protokolin e përgatiti: Abas Fejzullahi ,sekretar i BISHZ-së
Solothurn, 19 nëntor 2006*